



Në përputhje me nenin 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09 43/14, 193/15, 39/16, 164/18 dhe 190/19), Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural publikon e publikon këtë

**SHPALLJE PUBLIKE nr. 04/2021**  
për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për mbështetje financiare për zhvillimin rural për vitin 2021

**I. LËNDË E SHPALLJES**

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e mbështetjes financiare për masat e mëposhtme:

KAPACITET E PRODHIMIT TË KËRKUESIT		
Kodi i masës	Emri i masës	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues
121	<b>Investime për modernizimin e ekonomive bujqësore</b>	
121.1	Furnizimi i bagëtime të importuara ose nga organizatat e njohura të mbarështuesve në përputhje me Ligjin për Blegtori (të regjistruar në Regjistrin e organizatave të njohura të blegtorëve, jo më vonë se data e përfundimit të thirrjes publike) edhe atë për: - mëshqerra të qumështit me origjinë të lartë, mish dhe qumësht-mish dhe mish-qumësht të kombinuar (me përjashtim të racës Busha), - kokë meshkuj dhe femra me pedigree për mbarështim të deleve - kokë meshkuj dhe femra me pedigree për mbarështim të dhive	deri në 6.500.000 denarë kosto të pranueshme për përdorues individual

**II. SHFRYTËZUESIT**

Të drejtë në shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Kodi i masës
Pronat bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Vetëm të Pronave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në përputhje me Ligjin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	Masa 121

**III. SHUMA E MBËSHETJES FINANCIARE**

Mjetet janë të destinuara për investime për furnizim të bagëtime, të parapara me Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021. Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues për Masën 121.1 është 6.500.000,00 denarë. Mjetet ndahen për periudhën e realizimit të planit afarist dhe paguhet në nivel vjetor.

**IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË DORËZOHET**

Kërkesat dorëzohen në mënyrë elektronike pas regjistrimit të bërë në [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk)  
Një aplikant mund të paraqesë vetëm një kërkesë për një masë ose maksimumi 2 kërkesa për mbështetje nën masa të ndryshme, duke marrë parasysh masat e tjera të Programit të Mbështetjes Financiare të Zhvillimit Rural për vitin 2021.  
Kushtet që duhet të plotësojnë aplikantët përcaktohen nga:

- Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2021 ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 12/21, 31/21, 53/21, 79/21 dhe 92/21)
- Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 88/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16 dhe 74/17, 83/18)
- Rregullorja për kriteret më të afërta për përzgjedhjen e përfituesve sipas masave për zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18, 100/19, 215/19, 24/20 dhe 96/21)
- Rregullorja për kushte më të afërta shtesë për mbështetjen e masave të zhvillimit rural, kostot e pranueshme dhe shumën e mbështetjes për kostot e pranueshme për përdorues për masë individuale ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" Nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16, 178/18, 77/19 dhe 214/19).

Aplikantët për mbështetje financiare duhet të krijojnë një kërkesë elektronike për mbështetjen financiare me të dhënat e kërkuara për lokacionin e investimit, të dhënat e investimit dhe në mënyrë elektronike t'i ngarkojnë dokumentet e duhura të parapara për masën 121, nënmasa 121.1.  
Aplikantët të cilët i plotësojnë kushtet për shfrytëzimin e mjeteve për masën 121 rangohen me vlerësim me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masat e zhvillimit rural ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18, 100/19, 215/19, 24/20 dhe 96/21).

- Kërkesat me numër të njëjtë pikësh do të rangohen sipas datës dhe kohës për parashtrimin e kërkesës elektronike në [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk)
- Aplikuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para lidhjes së Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë
- Kërkesat që nuk parashtrihen në formë elektronike në [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk) nuk do të shqyrtohen.

**V. TËRHEQJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMET**

Udhëzimet për regjistrimin e aplikantëve në sistemin e paraqitjes elektronike të kërkesës mund të shkarkohen në faqen kryesore të [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk). Udhëzuesi i përdorimit për masën individuale mund të shkarkohet pasi të filloni të krijoni një kërkesë për masën. Udhëzuesi për shfrytëzuesit mund të tërhiqet nga ueb faqja e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk), ose mund të merret direkt në Agjencinë çdo ditë pune prej orës 08:30 deri 16:30 në adresën:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural  
bul. "3 Makedonska brigada" nr.20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C) 1000 Shkup

**VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE**

Kërkesat e plotësuar në mënyrë elektronike për mbështetjen financiare duhet të shkarkohen, printohen dhe nënshkruhen dhe së bashku me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen deri te Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural në një zarf të mbyllur të shënuar në pjesën e përparme të zarfit në këndin e sipërm të majtë **Kërkesë për mbështetje financiare dhe numri i arkivit i Kërkesës (0421-12116-XXXX/1)**. Kërkesa mund të dorëzohet me postë të rekomanduar ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritje të vonuar ose të pakompletuar në sportel ose hapje të parakohshme të kërkesës.

Afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesave është **04.07.2021**.

Informacione më të hollësishme në tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën:

[ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe  
faqen e internetit: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)

Kontakti:

Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural,  
Sektori për aprovimin e projekteve  
Telefoni: 02 3097-460, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në orën 16:00



# AGJENCIA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)